



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 4 mars 2022
Nr. ref.:RK 1953/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI87/21

Parashtrues

Ukë Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AA. nr. 7/2021,
të 5 shkurtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ukë Berisha, nga fshati Dobërdol, si përfaqësues i pretenduar i subjektit politik "Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës" (në tekstin e mëtejshëm: PSHDK), (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Artan Qerkini, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin AA. nr. 7/2021, e Gjykatës Supreme të Kosovës të 5 shkurtit 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), dhe me nenet 7 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) që të mbajë një dëgjim të palëve në procedurë.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr.03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 7 maj 2021, Gjykata e pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
7. Më 18 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).
8. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të paragrafit 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës u konfirmua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani do të merrte pozitën e Kryetares së Gjykatës pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
9. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullin 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.

10. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin KSH 87/21, e caktoi gjyqtarin Radomir Laban si anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
11. Më 3 qershor 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit për regjistrimin e kërkesës.
12. Gjithashtu në të njëjtën ditë, Gjykata i njoftoi institucionet në vijim të Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës: i) Gjykatën Supreme të Kosovës; ii) Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; iii) Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP); iv) Institucionin e Avokatit të Popullit; dhe në të njëjtën kohë u dërgoi të gjithëve një kopje të kërkesës.
13. Më 26 qershor 2021, në bazë të paragrafit (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës Nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa në bazë të pikës 1.1, paragrafi 1, i nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi e përfundoi mandatin e Kryetares dhe gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 27 korrik 2021, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e parashtroi një urgjencë në Gjykatë, në të cilën deklaronte:

„Marrë parasysh rrethanat e rastit si dhe bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në rastet me implikime partiake dhe politike, përmes kësaj parashtrese, me respekt të veçantë kërkojmë nga kjo Gjykatë që rasti i cili është identifikuar si rasti KI 87/21 të trajtohet me urgjencë. Kjo urgjencë kërkohet nga fakti se, siç u theksua më lart, ka të bëjë me çështje partiake dhe, siç e dimë, ne jemi në një kohë kur zgjedhjet komunale janë afër dhe partitë politike duhet të jenë sa më të kompletuara që është e mundur si në struktura ashtu edhe në planin e tyre në mënyrë që të arrijnë rezultatet e dëshiruara në zgjedhje”.

15. Më 20 janar 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Që në fillim të përmbledhjes së fakteve në lidhje me rastin në fjalë, Gjykata dëshiron të theksojë se kontesti në fjalë ka të bëjë me çështjen e organizimit të brendshëm të subjektit politik PSHDK. Më konkretisht, me çështjen e legjitimitetit të mbajtjes së kuvendit zgjedhor në subjektin politik PSHDK, në të cilin u zgjodh kryetari i ri, dhe të cilën parashtruesi i kërkesës si kryetar i mëparshëm e kundërshtoi para organeve kompetente, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshëm: KQZ) dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.
17. Në bazë të shkresave të lëndës, rrjedh se subjekti politik PSHDK e njoftoi Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (në tekstin e mëtejshëm: ZRPPC) se gjatë muajit qershor 2020 do të mbajë një mbledhje të subjektit të vet politik.

18. Më 23 qershor 2020, subjekti politik PSHDK i dërgoi një kërkesë KQZ-së, përmes së cilës kërkoi shtyrjen e Kuvendit Zgjedhor, me ç'rast kërkoi që afati i fundit për mbajtjen e tij të caktohet më 31 tetor 2020.
19. Më 24 qershor 2020, KQZ përmes Shkresës nr. 796/2020 e miratoi kërkesën e subjektit politik PSHDK, si në lidhje me shtyrjen e kuvendit, ashtu edhe në lidhje me përcaktimin e afatit të ri për mbajtjen e tij.
20. Në ndërkohë, ZRPPC-ja mori dy shkresa nga dy grupe të sapoformuara të subjektit politik PSHDK. Njëri grup përfaqësohej nga parashtruesi i kërkesës si ish -kryetar i subjektit politik të PSHDK-së, ndërsa grupin tjetër e përfaqësonte zëvendëskryetari i PSHDK -së. Në të dy shkresat e dorëzuara në ZRPPC thuhej, *“se kuvendi zgjedhor i subjektit politik PSHDK do të mbahet më 31 tetor 2020”*, në dy lokacione të ndryshme, në Prishtinë dhe në Gjakovë.
21. Më 31 tetor 2020, u mbajtën dy kuvende zgjedhore të subjektit politik PSHDK, në vende të ndryshme, në Prishtinë dhe Gjakovë.
22. Në kuvendin zgjedhor të subjektit politik PSHDK, i cili u mbajt në Gjakovë, 131 delegatë votuan që kryetari i ri i PSHDK-së të ishte Zef Morina, ndërsa në kuvendin zgjedhor të subjektit politik PSHDK, i cili u mbajt në Prishtinë, gjithsej 118 delegatë votuan që Ukë Berisha (parashtruesi i kërkesës) të vazhdojë të kryej detyrën e kryetarit të partisë edhe për një mandat tjetër.
23. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 4 nëntor 2020, ZRPPC-së iu dorëzuan të gjitha dokumentet dhe rezultatet e votimit nga mbledhja e mbajtur në Gjakovë, ndërsa më 5 nëntor 2020, ZRPPC-së iu dorëzuan të gjitha dokumentet dhe rezultatet e votimit nga mbledhja e mbajtur në Prishtinë.
24. Më 24 dhjetor 2020, KQZ-ja përmes postës elektronike i dërgoi parashtruesit të kërkesës Konstatimin 876/2020, me të cilin e informonte atë se KQZ-ja e njohu si të rregullt kuvendin zgjedhor të PSHDK-së, të mbajtur në Gjakovë më 31 tetor 2020, dhe me të njëjtin urdhër e refuzon si të parregullt kuvendin e mbajtur në Prishtinë më 31 tetor 2020, përderisa Zef Morina konsiderohet kryetar i porsazgjedhur i partisë politike PSHDK.
25. Më 26 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës përmes postës dërgoi dy ankesa, kundër Konstatimit Nr. 876 të 24 dhjetorit 2020, në mënyrë specifike në KQZ dhe PZAP.
26. Në të dyja ankesat, parashtruesi i kërkesës pretendoi: **a)** shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës ligjore, duke vendosur në plan të parë faktin se: *“Konstatimi ka mungesë në përmbajtje dhe në bazën ligjore të cilës i referohet, po ashtu nuk përmban formën e aktit e as të këshillës juridike se në cilin organ dhe afat ligjor mund të parashtroj ankesë”*; **b)** Zbatimin e gabuar të ligjit material, duke vënë në plan të parë faktin se: *“Me Statutin e PSHDK-së të miratuar në Kuvendin e partisë më 26.03. 2016, i cili është akti më i lartë i partisë, është kompetencë ekskluzive e kryetarit të caktoj kuvendin, kjo e përcaktuar me nenin 9 pika 9.1 dhe nenin 19.3 pika d, prandaj çdo kuvend tjetër i caktuar është në kundërshtim me statutin sepse kryetari nuk ka qenë në mungesë, dhe se z. Berisha si kryetar i partisë ka komunikuar me KQZ -në për*

mbajtjen e kuvendit dhe se çdo komunikim tjetër nga Z. Morina ka qenë i paautorizuar nga kryetari”.

27. Më 30 dhjetor 2020, PZAP dërgoi përgjigjen Nr.Ref. ZKS/PZAP, drejtuar parashtruesit të kërkesës në ankesën e tij të paraqitur më 26 dhjetor 2020. Në përgjigje thuhet :

“Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia – PZAP-i, përmes kësaj parashtrëse ju njofton se kërkesën e juaj e vlerëson vetëm si paralajmërim lidhur me shkeljet e prenduara dhe ju mund ta paraqisni kërkesën e njëjtë apo tjetër kërkesë në PZAP, pasi që Komisioni Qendror Zgjedhor - KQZ të vendosë lidhur me ankesën që e keni paraqitur në atë institucion.”

28. Më 27 janar 2021, KQZ i dërgoi parashtruesit të kërkesës *“Përgjigje në Ankesën kundër Konstatimit të ZRPPC -së Nr. 876, të datës 24.12.2020”* në të cilin qëndron:

- i) Sa i përket konstatimeve për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, nuk është prezantuar asnjë dëshmi se cilat dispozita janë shkelur vetëm është përmendur Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulla 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, andaj Zyra nuk mund të japim përgjigje për këtë çështje.*
- ii) Sa i përket anikeses në lidhje me formën e aktit juridik, Zyra nuk është e obliguar që për kontestet e brendshme të subjekteve politike të lëshoj vendim, për këtë arsye në Konstatim nuk është përfshirë këshilla juridike.*
- iii) Pretendimi ankimor tjetër se Zyra do të duhet të ndalonte mbajtjen e dy Kuvendeve Zgjedhore gjithashtu nuk ka bazë ligjore sepse Zyra nuk behet pale në çështjet e brendshme të subjektit politik dhe është e obliguar të vëzhgojë çdo Kuvend Zgjedhor për të cilin i dërgohet ftesa ...*
- iv) Sa i përket të gjitha çështjeve të brendshme apo pretendimeve se janë bërë shkelje statutare, çdo pale e interesuar e cila është pjesë e partisë politike, duhet t'i drejtohet komisionit statutar të partisë e që themelohet nga Kryesia e PSHDK, bazuar në nenin 41.1 të Statutit të PSHDK. Rrjedhimisht, ju rekomandojmë që pretendimet tuaja ankimore t'i orientoni në kuadër të strukturave partiake.*

29. Më 28 janar 2021, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në PZAP, kundër përgjigjes së KQZ -së në ankesën kundër Konstatimit Nr. 876, të 24 dhjetorit 2020. Në ankesë, parashtruesi i kërkesës në esencë i theksoi argumentet e njëjta ankimore si në ankesën e parashtruar në KQZ.

30. Më 2 shkurt 2021, PZAP nxori Vendimin A. nr. 24/2021, me të cilin e miratoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, e anuloi Konstatimin 876/2020 të 24 dhjetorit 2020, dhe urdhëroi ZRPPC -në që ta njoftojë subjektin politik PSHDK në lidhje me mbajtjen e një kuvendi të ri.

31. Në arsyetimin e vendimit, PZAP deklaroi:

“[...] Paneli ka gjetur se Kuvendi Zgjedhor i mbajtur në Gjakovë më 31 tetor 2020, është në kundërshtim me statutin e këtij subjekti dhe me Rregullën Zgjedhore të theksuar më lart. Kjo për faktin se ky Kuvend Zgjedhor është mbajtur me kërkesën e zëvendës kryetarit të PSHDK -së, Zef Morina, i cili në këtë rast ka qenë i paautorizuar nga kryetari i këtij subjekti për thirrjen dhe mbajtjen e këtij Kuvendi Zgjedhor. Po ashtu Paneli e shpalli si të pavlefshëm edhe Kuvendin Zgjedhor të PSHDK -së, të mbajtur në Prishtinë, më datën 31 tetor 2020, në “Sallën e Kuqe” të Pallatit të Rinisë, për arsye se i njëjti nuk është thirrur në pajtim me Statutin e subjektit politik PSHDK, pasi që edhe pse me nenin 9 të Statutit të PSHDK-së parashihet që thirrja e Kuvendit Zgjedhor bëhet nga kryetari i kësaj partie në konsultim me zëvendës kryetarin, e në këtë rast e njëjta nuk është bërë në pajtim me Statutin as edhe nga Kryetari të këtij subjekti politik.”

“Në këtë rast, Paneli arriti në përfundim se me këtë veprim KQZ-ZRPPC në mënyrë të heshtur ka marrë vendim, me të cilin e ka pranuar si të rregullt Kuvendi Zgjedhor të PSHDK-së, të mbajtur në Gjakovë, më 31 tetor 2020, në Shtëpinë e Kulturës “Asim Vokshi”, duke mos udhëzuar palën që kontestin ta zgjidhë në përputhje me Statutin e këtij subjekti politik, ashtu siç parashihet në Statut, por duke nxjerrë vendim me të cilin në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi të KQZ-së/ZRPPC-së , me Nr. Protokolli 876/2020, të datës 24 dhjetor 2020, e ka konsideruar si kryetar të partisë Zef Morinën, i cili ishte zv. kryetar i të njëjtës, pa ndonjë mbështetje ligjore për të nxjerrë një vendim të tillë”.

“Nga e gjithë kjo rezulton se Zyra në rastin konkret në kuadër të autorizimeve të saj e ka vëzhguar kuvendin zgjedhor duke nxjerrë vendimin e lartcekur Nr. 876, të datës 24 dhjetor 2020, pasi që me në nenin 19 të Statutit të PSHDK-së parashihet se “Kryetarin e PSHDK-së e zgjedh dhe shkarkon Kuvendi i PSHDK-së”, dhe në rastin konkret kryetari i kësaj partie, Ukë Berisha, nuk është shkarkuar nga organi kompetent.”

32. Subjekti politik PSHDK-së, i përfaqësuar nga Zef Morina, paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të PZAP A. nr. 24/2021, duke pretenduar, ndër të tjera, *“paligjshmërinë e vendimit, se vendimi i ankimuar i PZAP -it ishte i pabazuar, pasi që edhe deklaratat e paraqitura nga ish -kryetari i PSHDK-së janë gjithashtu plotësisht të pabazuara”.*
33. PZAP paraqiti përgjigje në ankesë në Gjykatën Supreme, në të cilën i kontestoi pretendimet ankimore dhe propozoi që ankesa të refuzohej si e pabazuar.
34. Më 5 shkurt 2021, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin AA.nr.7/2021, me të cilin: e miratoi si të bazuar ankesë e paraqitur nga subjekti politik PSHDK, të cilin e përfaqëson Zef Morina, dhe e anuloi vendimin e PZAP-it, A.nr. 24/2021, të 2 shkurtit 2021.
35. Me të njëjtin aktvendim, Gjykata Supreme e hodhi poshtë si të palejueshme ankesën e parashtruesit të kërkesës Ukë Berisha, kryetar i subjektit politik

PSHDK, të parashtruar më 20 janar 2021, PZAP-it, kundër përgjigjes në ankesën kundër Konstatimit me Nr. Protokolli 876/2020, të 24 dhjetorit 2020, në KQZ, Zyra ZRPPC.

36. Në arsyetimin e vendimit të tillë, Gjykata Supreme deklaroi:

„Gjykata Supreme e Kosovës, nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, nuk mund të pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, [...] sepse nga vendimi i PZAP-it dhe shkresave të tjera të lëndës është vërtetuar se apelimi- ankesa e ushtruar nga Ukë Berisha, në cilësinë e kryetarit të subjekti politik PSHDK, të paraqitur më 28 janar 2021, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, kundër përgjigjes në ankesën - kundër Konstatimit me Nr. Protokolli 876/2020, të datës 24 dhjetor 2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), është e palejueshme.

Përgjigja në ankesë e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), të lëshuar përmes Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), me shkresën nr.111/2021, të datës 27 janar 2021, me të cilën i janë përgjigjur z. Ukë Berisha, pa vendosur lidhur me ankesën, me rekomandim që pretendimet ankimore t'i orientoj në kuadër të strukturave partiake, nuk paraqet vendim kundër të cilit mund të ushtrohet ankesë konform nenin 122.1 pika a), b), c), d), f) të Ligjit nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në rastin konkret me rastin e dhënies së përgjigjes n.111/2021, të datës 27 janar 2021, nuk është vendosur për asnjë të drejtë, dhe nuk mund të trajtohet si vendosje sipas ankesës në raport me Konstatimin me Nr. Protokolli 876/2020, të datës 24 dhjetor 2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Zyra për Regjistrimin e Partive, pasi ndaj te njëjtit, nuk është lejuar ankesë brenda KQZ-së, por është dashur vetëm të apelohej ne PZAP, për këtë arsye ndaj kësaj përgjigje te KQZ-se, nuk mund te ushtrohet apel ne PZAP.

Ndërsa ushtrimi i njoftimit -ankesës kundër konstatimit-vendimit te KQZ-ZRPPC, me Nr. Protokolli 876/2020, të datës 24 dhjetor 2020, nga Ukë Berisha, kryetar i subjektit politik PSHDK, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), është bërë me datë 30.12.2020, në orën 10 e 50 minuta, e cila është ushtruar pas afatit ligjor, pasi në këtë ankesë, parashtruesi e pranon se Konstatimin me Nr. Protokolli 876/2020, të datës 24 dhjetor 2020, te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve (KQZ), Zyra për Regjistrimin e Partive, e ka pranuar me datë 24.12.2020, përmes postës elektronike – e-mailit, rreth orës 15:00, është i pas afatshëm, pasi që është ushtruar pas afatit ligjor prej 24 ore. Fakti se kundër këtij vendimi është ushtruar ankese edhe ne KQZ, nuk ndikon ne afatin e përcaktuar ligjor, siç është përcaktuar me nenin 15, të Ligjit nr.03/L-256, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës,

Po ashtu edhe me Rregullën Nr. 01/2013, për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, të nxjerr nga KQZ, me nenin 9, është rregulluar në cilat

raste është mundësia e ankimimit të vendimeve të KQZ-së, dhe afati i ankimimit, ku është përcaktuar se “Subjekti politik ose personi fizik, ka mund të ushtrojë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) brenda njëzet e katër orëve (24) orëve, kundër vendimit të KQZ-se, me të cilin refuzohet kërkesa e saj për: regjistrim, bashkim, shkrirje dhe vendimit të KQZ-së për pezullim dhe çregjistrim, çka do të thotë se ndonëse nuk është titulluar vendim, por vetëm konstatim dhe nga përmbajtja është vendim kundër të njëjtit ka mundur të ushtrohet ankimimi në PZAP, sipas kësaj dispozite brenda afatit ligjor prej 24 orë, ndërsa fakti se është drejtuar me ankesë KQZ-së, nuk e shtynë afatin e ankesës. Po ashtu fakti se Ukë Berisha, në cilësinë e kryetarit të subjektit politik PSHDK, ka njoftuar PZAP-in, lidhur me ushtrimin e ankesës drejtuar KQZ-se, është pa efekt, pasi edhe po të trajtohej si ankesë është pas afatit ligjor, ndonëse PZAP, me shkresën 96/3, të datës 30.12.2020, i është drejtuar Ukë Berisha, kryetar i PSHDK-së, me të cilën e njofton se shkresën e tij nuk e trajton si ankesë, por vetëm paralajmërim, dhe se mund të paraqitni kërkesën e njëjtë apo kërkesën tjetër në PZAP, pasi që KQZ, të vendosë lidhur me ankesën tuaj të paraqitur në këtë institucion...”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

37. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme atij i shkelën të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, dhe me nenet 7 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.
38. Më konkretisht, sa i përket shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se: “në procedurën gjyqësore para Gjykatës Supreme është shkelur neni 31 i Kushtetutës, sepse atij i **i**) i është mohuar e drejta për qasje në gjykatë”, dhe **ii**) i është mohuar e drejta për të paraqitur argumente “Barazia të Armëve”.
39. Përkitazi me pretendimin për **i**) mohimin e së drejtës për qasje në gjykatë, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme, atij i ka mohuar të drejtën në qasje në gjykatë, ashtu që „Hudhet si i palejueshëm apeli i parashtruesit Ukë Berisha, kryetar i subjektit politik PSHDK, të paraqitur me datë 28 janar 2021, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, kundër përgjigjes në ankesën kundër Konstatimit me Nr. Protokoli 876/2020, të datës 24 dhjetor 2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC“.
40. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës shton se është i gabuar qëndrimi i Gjykatës Supreme se ankesa e tij e parashtruar më 30 dhjetor 2020, “është e pasafatshme, që e bën ankesën të palejueshme” dhe atë nga fakti se pas paraqitjes së Ankesës përmes postës, në KQZ dhe në PZAP, Parashtruesi nga PZAP pranon Përgjigjen në Parashtrësë, me anë të së cilës njoftohet se apelimin në PZAP mund ta bëjë vetëm pas kthimit të përgjigjes nga ana e KQZ. Dhe, Parashtruesi duke vepruar sipas shkresës së PZAP, pas përgjigjes që merr nga

KQZ me datë 27.01.2021, brenda afatit të ri ligjor (24 orë), me datë 28.01.2021, paraqet ankesën e tij në PZAP. Me këtë vërtetohet se Parashtruesi ankesën e tij e ka paraqitur brenda afatit ligjor dhe se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme të Kosovës, i cenon Parashtruesit të drejtën e tij të garantuar me Nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe me paragrafin 1 të Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

41. Më tej, përkitazi me pretendimin për i) Mohimin e të drejtës për të paraqitur argumente “Barazia e Armëve”, parashtruesi i kërkesës pretendon *“se Gjykata Supreme e Kosovës ka dëgjuar pretendimet e vetëm një pale dhe parashtruesit nuk iu dha mundësia për t’u mbrojtur para gjykatës, duke paraqitur provat dhe argumentet e tij në lidhje me lëndën e kërkesës, si dhe në lidhje me pretendimet e palës tjetër në procedurë gjyqësore”.*
42. Në kontekstin e shkeljes së pretenduar, parashtruesi i kërkesës shton: *“Në rastin aktual në shqyrtim, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi të anulojë vendimet e PZAP -it, vetëm në bazë të pretendimeve të një subjekti të interesuar, me ç’rast nuk i dëgjoi pretendimet e tij në lidhje me rastin i cili është duke u shqyrtuar. Në këtë mënyrë, ai u vendos në një pozicion krejtësisht të pafavorshëm në raport me palën tjetër”.*
43. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës e citon edhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI103/10.
44. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme gaboi kur hodhi poshtë ankesën e tij të parashtruar më 28 janar 2021 si të pas afatshme, duke shkelur kështu *“të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj, pra, të drejtën e qasjes në gjykatë”.*
45. Më tej, sa i përket shkeljes së të drejtave të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenet 7 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, parashtruesi i kërkesës nuk i arsyeton ato në hollësi, por vetëm konstaton se:

“Të drejtat e garantuara sipas nenit 24 në lidhje me nenin 3 (2) të Kushtetutës njihen dhe garantohen gjithashtu edhe përmes nenit 7 të Deklaratës Universale, i cili thotë se “[...]Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji.Të gjithë kanë të drejtën për t’u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë”.
46. Për sa i përket kërkesës për mbajtjen e një seancë dëgjimore, parashtruesi i kërkesës këtë pretendim e shpjegon ekskluzivisht vetëm me një deklaratë: *“në pajtim me Rregulloren 39 të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të URDHËROJ mbajtjen e dëgjimit”.*
47. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: i) ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme; ii) të konstatojë se me vendimin AA.nr. 7/2021 të Gjykatës Supreme të 5 shkurtit 2021, shkelet neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafi 1, i nenit 6 [E drejta për një proces të

rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj; iii) të deklarojë të pavlefshëm vendimin AA.nr. 7/2021 të Gjykatës Supreme, të 5 shkurtit 2021; dhe iv) ta kthejë çështjen në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në përputhje me aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

48. Gjykata, së pari shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

50. Në vijim, Gjykata i referohet edhe kriterëve të pranueshmërisë, siç janë paraparë me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

51. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin AA. nr. 7/2021 të Gjykatës Supreme, të 5 shkurtit 2021, pasi që ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka theksuar të drejtat dhe liritë për të cilat ai pretendon se i janë shkelur, në përputhje me kërkesat e nenit 48 të Ligjit si dhe e ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

52. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullës 39 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

53. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në baze të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

54. Gjykata gjithashtu rikujton se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kemmachev kundër Francës*, kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Letonisë*, kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).

55. Duke u kthyer te rasti konkret, ajo që Gjykata së pari vëren në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës është fakti se ai e ka ndërtuar kërkesën ekskluzivisht në bazë të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ -së. Më konkretisht, parashtruesi konsideron se në rastin e tij është shkelur neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe neni 10 i Deklaratës Universale për shkak se, siç pretendon ai, Gjykata Supreme:

- i) I ka mohuar të drejtat e “qasjes në gjykatë”, dhe
- ii) I ka mohuar të drejtën për paraqitjen e argumenteve, që në mënyrë implicite korrespondon me parimin e “barazisë së armëve”.

56. Mbi këtë bazë, është e qartë se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së e sjell ekskluzivisht në lidhje me vendimin e Gjykatës Supreme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mohimin e të drejtës së qasjes në gjykatë

57. Në lidhje me këtë, përkitazi me pretendimin për mohimin e së drejtës për qasje në gjykatë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e sjell atë pretendim ekskluzivisht në lidhje me faktin se Gjykata Supreme „*Hodhi poshtë si të palejueshëm apelin e parashtruesit Ukë Berisha, kryetar i subjektit politik PSHDK, të paraqitur me datë 28 janar 2021, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, kundër përgjigjes në ankesën kundër Konstatimit me Nr. Protokoli 876/2020, të datës 24 dhjetor 2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim-ZRPPC*”.
58. Gjykata rikujton se, në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, qasja në gjykatë është pjesë përbërëse e nenit 6 paragrafi 1, për rrjedhojë, pamundësia e qasjes në gjykatë është e pranishme në çdo situatë kur një person ankohet se nuk ka pasur mundësi t'i drejtohet gjykatës kompetente për të shqyrtuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me faktet dhe normat juridike në kontestin në fjalë dhe nxjerrjes së vendimit detyrues. Kjo e drejtë zbatohet në mënyrë të barabartë për personat që kërkojnë një vendim gjyqësor në një çështje civile dhe për personat e akuzuar për kryerjen e një veprë penale.
59. Gjykata rikujton se GJEDNJ për herë të parë këtë të drejtë e përcaktoi në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kur mori qëndrimin se garancitë e përmendura në mënyrë të detajuar të së drejtës për gjykim të drejtë në nenin 6 të KEDNJ-së nuk do të kishin kuptim nëse nuk do të ekzistonte mundësia për fillimin e procedurës gjyqësore (shih rastin GJEDNJ *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 4551/70, të 21 shkurtit 1975, si dhe rastet e tjera të GJEDNJ-së: *Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, aktgjykim i 12 nëntorit 2002; *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, aktgjykim i 25 janarit 2000 dhe *Nait-Liman kundër Zvicrës*, aktgjykim i 15 marsit 2018).
60. Gjykata, duke u bazuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, gjithashtu ka theksuar se e drejta e qasjes në gjykatë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykate të jetë efektive, individit duhet të ketë gjithashtu një mundësi të qartë dhe reale për të kontestuar vendimin që shkel të drejtat e tij/saj. Konkretisht, e drejta e qasjes në gjykatë nuk shterohet vetëm në të drejtën për të filluar procedurën në gjykatë, por kuptimi i saj është shumë më i gjerë pasi që përfshin të drejtën për “zgjidhjen” e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente (shih më lart, rastin KI62/17 me parashtruese *Emine Simnica*, paragrafi 55, rasti KI224/19, me parashtrues *Islam Krasniqi*, paragrafi 39 dhe rastin KI20/21, me parashtruese *Violeta Todorović*, paragrafi 43).
61. Gjykata, duke i sjellë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me qasjen në gjykatë, është e mendimit se në rastin konkret nuk kontestohet nëse

- parashtruesi i kërkesës kishte të drejtë për qasje në gjykatë me qëllim të ushtrimit të të drejtave të tij civile apo jo. Kjo pasi parashtruesi i kërkesës, pas ushtrimit të ankesës në këtë rast, ka ushtruar të drejtën që të vendoset për të drejtat e tij civile si në PZAP, po ashtu edhe në gjykatë, përkatësisht ka ushtruar të drejtën e qasjes në gjykatë, si një nga parimet nga neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së.
62. Më konkretisht, vetë fakti që parashtruesi i kërkesës ka arritur që organet kompetente të KQZ-së si dhe gjykatat e rregullta të rishqyrtojnë dhe të nxjerrin vendimet e kontestuara, konfirmon në mënyrë të pamohueshme se në rastin konkret është ushtruar e drejta e parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë. Kjo pasi organet përgjegjëse, respektivisht KQZ e PZAP, si dhe Gjykata Supreme shqyrtuan dhe vendosën në merita të këtij rasti, që në vetvete përjashton ekzistencën e shkeljes së të drejtës së qasjes në gjykatë sipas nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së. Një përfundim i tillë i Gjykatës është në përputhje me praktikën e saj, ku ka konstatuar qartë se “[...] *drejta në gjykatë ndër të tjera përfshin edhe të drejtën për “zgjidhjen” e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente* (shih paragrafin 59 të këtij Aktvendimi).
63. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme ka marrë qëndrim të gabuar se ankesa e tij e parashtruar më 30 dhjetor 2020, *“është e pasafatshme, që e bën ankesën të palejueshme”*, e të cilën parashtruesi e ndërlihdh me parimin e “qasjes në gjykatë”, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e ka arsyetuar hollësisht se çfarë konsiderohet përgjigje e institucionit kompetent, dhe se ndaj çka mund të parashtrohet ankesa. Konkretisht, Gjykata gjen se përfundimi i Gjykatës Supreme, ndër të tjera, ka qenë, “...edhe pse KQZ ka nxjerrë konstatim të 24 dhjetorit 2020, dhe jo vendim, vetë përmbajtja e konstatimit për nga përmbajtja dhe esenca e tij, paraqet vendim ndaj të cilit parashtruesi i kërkesës ka pasur të drejtë ankese në PZAP sipas Rregullit nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Punën e Partive Politike.
64. Gjykata vëren se Gjykata Supreme në pjesën që ka të bëjë me parashtrimin e ankesës dhe afatit u mor me interpretimin e Rregullit nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Punën e Partive Politike, që në vetvete edhe është kompetencë e gjykatës. Kjo Gjykatë gjithashtu rikujton se kompetenca e saj është e kufizuar “në çështje që i përmban kjo Kushtetutë” dhe se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të rishqyrtuar gjendjen faktike ose interpretimin e Rregullores ose zbatimin e ligjeve nga e gjykatave të rregullta, përveç në rastet kur vendimet e gjykatave më të ulëta shkelin të drejtat kushtetuese, pra nëse një gjykatë e rregullt gabimisht ka interpretuar ose zbatuar një të drejtë kushtetuese, Gjykata më tej rithekson se sipas Kushtetutës nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në esencë, roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih: *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI68/16, Parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri i 2 qershorit 2017, paragrafët 51 dhe 52, Rasti KI70/11, Parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*. Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e parimit të “barazisë së armëve”

65. Për më tepër, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të “barazisë së armëve” në Gjykatën Supreme, Gjykata rikujton se argumenti kryesor i parashtruesit të kërkesës është pretendimi “se Gjykata Supreme ka pranuar ankesën e subjektit politik PSHDK, të përfaqësuar nga Zef Morina, me ç’rast ka vendosur t’i anulojë vendimet e PZAP-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se vetë fakti që Gjykata Supreme e ndryshoi vendimin e PZAP-së, pa e dëgjuar atë si palë në procedurë, përbën shkelje të parimit të barazisë së armëve”. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se do t’i shqyrtojë ato ekskluzivisht në lidhje me vendimin e Gjykatës Supreme.
66. Gjykata vëren se, sipas praktikës së GJEDNJ-së, parimi i “barazisë së armëve”, nënkupton një trajtim të balancuar të palëve në procedurë dhe është një element kyç i së drejtës për gjykim të drejtë, si dhe një element integral i së drejtës për një seancë dëgjimore. Në thelb, kërkohet që secilës palë në procedurë t’i jepen mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e saj, duke përfshirë edhe dëshmitë, në kushte që nuk do ta vendosin atë palë në një pozitë esencialisht të varur përballë palës tjetër. Me fjalë të tjera, parimi i trajtimit të barabartë të palëve në procedurë nënkupton në thelb barazinë procedurale të palëve (shih GJEDNJ *Neumeister kundër Austrisë*, kërkesa nr. 1936/63, Aktgjykim i 27 qershorit 1968).
67. Ky parim zbatohet njësoj, si për procedurat civile, po ashtu edhe për ato penale. Në rastin e pabarazive të vogla të cilat nuk ndikojnë esencialisht në drejtësinë e procedurës në tërësi, kjo nuk përbën shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së (shih, aktgjykimi i GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 8950/80, të 30 nëntorit 1987).
68. Megjithatë, në mënyrë që Gjykata të përcaktojë nëse një palë ka marrë trajtim të balancuar në procedurën gjyqësore, ajo duhet së pari të përcaktojë thelbin e procedurës në gjykatë, në këtë rast në Gjykatën Supreme, në kontekstin e të drejtave të tij, të cilat parashtruesi i kërkesës konsideron se janë shkelur në atë procedurë.
69. Në lidhje me këtë, në rastin konkret, Gjykata konstaton se thelbi i procedurës në Gjykatën Supreme ka të bëjë me çështjen e ligjshmërisë së vendimit të PZAP, dhe rrjedhimisht si palë në procedurë, paraqitet subjekti politik PSHDK-së, i përfaqësuar nga Zef Morina, i cili parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme me qëllim të kontestimit të ligjshmërisë së vendimit të PZAP A. nr. 24/2021, ndërsa si palë tjetër në procedurën pranë Gjykatës Supreme paraqitet pikërisht PZAP, vendimi i të cilit në Gjykatën Supreme ishte objekt i vlerësimit gjyqësor. Me atë rast, të dyja palët (Zef Morina dhe PZAP) në procedurë në Gjykatën Supreme kanë paraqitur argumentet e tyre për të argumentuar ligjërisht bazueshmërinë e qëndrimeve të tyre që i kanë paraqitur dhe që i kanë marrë, gjë që mund të konkludohet në bazë të shkresave të lëndës.

70. Rrjedhimisht, për Gjykatën është e qartë se procedura në Gjykatën Supreme kishte të bënte ekskluzivisht me ligjshmërinë e vendimit të PZAP-së, e cila gjatë procedurës në Gjykatën Supreme paraqiti drejtpërdrejt argumentet e tij të cilat ishin indirekt në dobi dhe interes të parashtruesit të kërkesës, me qëllim që PZAP të arsyetojë dhe argumentojë ligjërisht ligjshmërinë e vendimit të saj.
71. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës nuk ishte palë e drejtpërdrejtë në procedurën në Gjykatën Supreme, por palë ishin subjekti politik PSHDK, i përfaqësuar nga Zef Morina, si dhe PZAP, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme përmes vendimit të saj kishte shkelur parimin e barazisë së armëve nuk janë të bazuara.
72. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimeve të “së drejtës për qasje në gjykatë” si dhe “barazisë së armëve”, Gjykata i konsideron si; (ii) pretendime që kategorizohen me “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe rrjedhimisht i hedh poshtë ato në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Pretendimet për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, si dhe nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut

73. Përveç kësaj, sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka shpjeguar në mënyrë specifike thelbin e kësaj shkeljeje. Megjithatë, në një paragraf të vetëm ai ka deklaruar se “*Të drejtat që garantohen sipas nenit 24 në lidhje me nenin 3 (2) të Kushtetutës njihen dhe garantohen gjithashtu edhe përmes nenit 7 të Deklaratës Universale, e cila thotë se “[...] Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t’u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që çënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë*”.
74. Nga vetë konstatimi i parashtruesit të kërkesës, Gjykata mundet vetëm të konkludojë se parashtruesi i kërkesës konsideron se ai është diskriminuar në ndonjë mënyrë.
75. Gjykata rikujton se, sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, në mënyrë që një çështje të mund të ngrihet sipas nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së, duhet të ketë një dallim në trajtimin e personave në situata të njëjta apo të ngjashme (shih, në mesin e shumë burimeve të tjera, *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Rusisë*, Aktgjykimi i vitit 2017, paragrafi 64; *X dhe të tjerët kundër Austrisë*, Aktgjykimi i vitit 2013, paragrafi 98; dhe *Konstantin Markin kundër Rusisë*, Aktgjykimi i vitit 2012, paragrafi 125).
76. Me fjalë të tjera, kriteri për të dëshmuar një situatë të njëjtë nuk kërkon që grupet e ngjashme (*comparator groups*) të jenë identike. Parashtruesi duhet të dëshmojë, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të ankesës së tij, se ai apo ajo ka qenë në një situatë në mënyrë domethënëse të ngjashme me të tjerët që u trajtuan ndryshe (shih *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i vitit 2010, paragrafi 66). Megjithatë, jo secila pabarazi në trajtim përbën shkelje të

nenit 14. Së pari, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore ka konstatuar se vetëm dallimet në trajtim në bazë të karakteristikave që mund të identifikohen ose në bazë të “statusit” mund të përbëjnë diskriminim në kuptim të nenit 14 (shih *Carson dhe të tjerët*, të cituar më sipër, paragrafi 61, dhe *Eweida dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 48420/10, paragrafi 86, aktgjykim i vitit 2013). Së dyti, dallimi në trajtim është diskriminues nëse për të nuk ka justifikime objektive dhe të arsyeshme; apo me fjalë të tjera, nëse me të nuk bëhet përpjekje të arrihet një qëllim legjitim ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih *Fabris kundër Francës*, Aktgjykim i vitit 2013, paragrafi 56; *Topčić-Rosenberg kundër Kroacisë*, Aktgjykim i vitit 2013, paragrafi 36, dhe *Weller kundër Hungarisë*, Aktgjykim i vitit 2009, paragrafi 27).

77. Megjithatë, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës nuk ka treguar ose identifikuar individin ose grupin në raport me të cilin është diskriminuar dhe me të cilin ka qenë në një situatë që është e ngjashme. Barra e provës në lidhje me trajtimin diskriminues bie mbi parashtuesin e kërkesës dhe me sa duket ai nuk e bëri këtë, pasi që ai nuk e ka shpjeguar këtë në vetë kërkesën dhe kështu nuk ka dëshmuar ekzistencën e diskriminimit të mundshëm (shih *Khamtokhu dhe Aksenchik*, të cituar në tekstin më lartë, paragrafi 65; *Vallianatos dhe të tjerë kundër Greqisë*, Aktgjykimi i vitit 2013, paragrafi 85, dhe *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykimi i vitit 2007, paragrafi 177).
78. Rrjedhimisht, Gjykata e konsideron këtë pretendim të parashtuesit të kërkesës si (iii) pretendim “të pambështetur apo të paarsyetuar”, dhe prandaj e hedh poshtë atë në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Pretendimet për shkeljen e nenit 3 të Kushtetutës

79. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, përkatësisht parimit të barazisë para ligjit, Gjykata thekson se neni i përmendur i Kushtetutës nuk bie nën Kapitullin II Të drejtat dhe liritë themelore të Kushtetutës, prandaj, përmes tij nuk garantohet asnjë e drejtë dhe liri themelore individuale. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konkludon se ajo nuk do të merret me këtë pretendim të parashtuesit të kërkesës.

Kërkesa për mbajtjen e dëgjimit publik

80. Gjykata vëren se, në mesin e pretendimeve të tjera në kërkesë, parashtuesi i kërkesës gjithashtu kërkon edhe mbajtjen e një seancë publike, pa dhënë ndonjë shpjegim specifik, e as arsye se pse do të ishte e nevojshme seanca publike.
81. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:

“1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.”

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.”

82. Gjkata vëren se nuk ka asnjë arsye të referuar nga parashtruesi i kërkesës në mbështetje të kësaj kërkesë.
83. Gjkata konsideron se dokumentet të cilat gjenden në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur këtë çështje në pajtim me formulimin e nenit 20, paragrafi 2 të Ligjit (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI34/17, parashtruese e kërkesës *Valdete Daka*, Aktgjykimi i 12 qershorit 2017, paragrafët 108-110).
84. Prandaj, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për të mbajtur seancë të shqyrtimit verbal refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 janar 2022, me shumicë votash,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për mbajtje të dëgjimit publik;
- III. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani